

**AKT-THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

ORLETTE

KREU I - THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

NENI 1

DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT

Sot, më date 23 Dhjetor 2024, ne pranine e Ortakeve Themeleues te Shoqerise ORLETTE SH.P.K te paraqitur si me poshte :

-Besmir Dishnica ,i biri i Ylli Dishnica,i datelindjes 02/12/1987 shtetas shqiptar,lindur ne Tiranë banues ne USA 43 S 750 E

American Fork

Utah, USA 84003 ,identifikuar me nr personall71202043Qdhe me zotesi te plote per te vepruar.

Neni 2

QËLLIMI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

Qëllimi i themelimit të Shoqërisë është qëllim i ligjshëm afarist, përfitimi personal i ortakëve dhe kontributi shoqëror në vendin ku jetojmë, me kontribute që kanë në thelb rritjen e mireqënies personale dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Neni 3

FORMA DHE EMRI LIGJOR I SHOQËRISË

Shoqëria Tregtare është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, shkurtimisht **SH.P.K.**

Emërtimi i plotë i shoqërisë është: Shoqëria Tregtare ORLETTE shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.



Neni 4

ADRESA E SELISË

Selia e ORLETTE . është në ; Bl. "Gjergj Fishta", P.6/1, - Tiranë,

Shoqëria mund të themelojë filiale, të hapë njësi brenda vendit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

OBJEKTI I AKTIVITETIT TË SHOQËRISË

Objekt i aktivitetit të shoqërise do të jetë çdo veprimtari e lejuar nga ligji, me pjesëmarrje në çdo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar, sic mund të ndryshohet here pas here dhe në vecanti verpimtarite e mëposhtme:

Aktiviteti kryesor; Shitje me shumice dhe pakice i orave,bizhu, syze dhe aksesore zbukurues te tjere.

Të gjitha veprimtaritë e Shoqërisë regjistrohen në Qendren kombetare të biznesit, e cila vepron sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 6

PERIUDHA E KOHËZGJATJES SË SHOQËRISË

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë si sh.p.k. do të jetë për një afat të pacaktuar.

KREU II - KAPITALI

Neni 7

KAPITALI

THEMELTAR



Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare është 100.000 (Njeqind mije) Leke.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- 1- Ortaku Z.Besmir Dishnica zotëron 1 kuote, me vlerë të përgjithshme 100.000 lekë (njeqind mije), që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 8

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 9

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

kontributit në kapitalin e shoqërisë;

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Ne cdo rast transferimi i pjeseve të kapitalit themeltar me vullnetin e ortakut duhet të vertetohet nepermjet nje akti noterial.



KREU III - ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 10

ORGANI VENDIMMARRES

Organi Vendimmarres Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton ndryshimet sipas modaliteteve te percaktuara me ligj .

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;



- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 11

MËNYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.

Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 12

VENDIMMARRJA

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;



Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise

Neni 13

ADMISTRATORI

Adminiostrator i parë i shoqërië emerohet z.Jurgen Mene i biri i Shefqet Mene me numer personal J40624068E emëruar ne këtë detyrë më datë 24.12.2024 deri me date 25/12/2029 banues ne Tiranë .Per emertimet pas administratorëve, ne aktin e emërimit përcaktohet edhe periudha e emërimit në detyrë. Në rast se kjo periudhë nuk është percaktuar në aktin e emërimit, ajo në cdo rast nuk mund të jete më shumë se pesë vjet, duke filluar ky afat nga data e emerimit.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të asamblese se ortakëve.

Neni 14

KOMPETENCAT DHE KUFIZIMET E ADMINISTRATORIT

Administratori ka këto kompetenca:

- të paraqitet, përfaqësojë në banka te nivelit të dytë dhe nënshkruajë për shoqërinë,
- të ekzekutoje vendimet e Asmblese se ortakëve,
- të udhëheqë afarizmin e shoqërisë,

- të organizoje dhe udhëheqë me procesin e punës, kryen veprime bankare
- përgatit pasqyrat vjetore të kontabilitetit dhe raportet mbi afarizmin,
- propozon organizimin e brendshëm të shoqërisë,
- i pranon në punë dhe iu shkëput Kontratën e punës punëmarrësve,
- vendos mbi sistemimin e punëmarrësve në vende punë ,

- kujdeset për ligjshmërinë e punës në shoqëri,
- vendos mbi procedurat disiplinore të të punësuarve,
- kryen edhe punë të tjera në harmoni me ligjin, Statutin dhe Vendimet e Asmblese se ortakeve.
- Të përfaq



KREU IV - VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 15

Viti

FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni16

EKSPERTE

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqërise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

KREU V PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 17

NDARJA, BASHKIMI DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË



Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Kompetencat e Administratorit si përfaqësues i shoqërisë mund të shtohen apo të reduktohen me vendim të ortakeve.

Neni 18

MOSMARRËVESHJET

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te lindë midis Shoqërise dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykatat e Republikës së Shqipërisë.

Neni 19

PERGJEGJËSITË

Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortaku në emrin e tij personal ndaj personave të tretë.



Neni 20

DISPOZITAT

PËRFUNDIMTARE

Ky Statut hyn në fuqi ditën që e aprovojnë Themeluesit e Shoqërisë.

Për të gjitha çështjet që nuk janë përcaktuar me këtë Statut do të aplikohen dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare

Tiranë më, 23 Dhjetor 2024

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

ORLETTE SHPK

Perfaqesuar nga:

Z.Besmir Dishnica

Besmir Dishnica
